**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të jetë në listën e subjekteve të certifikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ofrimin e zgjidhjeve të fiskalizimit (me para ne dore pa para ne dore E-invoice ose pa para ne dore E-invoice)

**Në respektim të nenit 36 te LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalent”.**

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Shtojca 8**
[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I**
**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

☐ Shërbim:
Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____

| Kontrata Nr. | Titulli i Kontratës | Përshkrim i shkurtër i kontratës |
|---|---|---|
| 01 | __________ | _______________ |
| 02 | __________ | _______________ |
| 03 | __________ | _______________ |
| … | __________ | _______________ |

**Shtojca 10**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: “Shërbim dhe mirëmbajtje e sistemit të Fiskalizimit”, si një zgjidhje softëare-ike për lëshimin e faturës dhe pranimin e faturës elektronike dhe fiskalizimin e lëshimit të faturës.

Afatet e ekzekutimit: Kohëzgjatja në 4 (katër) javë për zbatimin e zhvillimeve konfigurimeve dhe testimeve dhe 3 (tre) vjet mirëmbajtje.

**Shtojca 11**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

# TERMAT E REFERENCËS

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A**

## SHERBIMI DHE MIRËMBAJTJA E SISTEMIT TE FISKALIZIMIT

*(SI ZGJIDHJE SOFWARE-IKE PER LESHIMIN DHE PRANIMIN E FATURES ELEKTRONIKE DHE FISKALIZIMIN E LESHIMIT TE FATURES)*

**PËRMBAJTJA**

TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK ................................ **Error! Bookmark not defined.**
1 FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT .......................... **Error! Bookmark not defined.**
1.1 Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit **Error! Bookmark not defined.**
2 NËNSHKRIMET MIRATUESE .......................................... **Error! Bookmark not defined.**
3 PËRMBAJTJA ........................................................................ 34
1. HYRJE ........................................................................ 36
1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues ........................................ 36
1.2. Historiku ........................................................................ 36
1.3. Situata Aktuale ........................................................................ 36
2. OBJEKTIVAT, RISQET, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA ........................ 38
2.1. Objektivi i Përgjithshëm ........................................................ 38
2.2. Qëllimi ........................................................................ 39
2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori ........................ 39
· Integrimi me modulin e Finances te platformes ERP (mbas zbatimit te platformes ERP); 39
· Trajnimi i punonjësve te ngarkuar me përdorimin e sistemit, n ........................ 39
2.4. Supozimet e projektit ........................................................ 39
2.5. Rrisqet ........................................................................ 40
2.6. Hapsira gjeografike dhe vendodhja ........................................ 40
2.7. Siguria e Sistemit ........................................................ 40
3. DETYRAT SPECIFIKE ........................................................ 40
3.1. Dizenjimi i sistemit ........................................................ 40
3.2. Zhvillimi i sistemit ........................................................ 41
3.3. Planifikimi i testimit të sistemit ........................................ 41
3.4. Instalimi dhe marrja në dorëzim ........................................ 41
3.5. Fiskalizimi i leshimit te fatures nga platforma ERP ........................ 41
4. LOGJISTIKA DHE KOHA ........................................................ 41
4.1. Vendndodhja ........................................................................ 41
4.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave ........................ 42
5. RAPORTIMI ........................................................................ 42
5.1. Kërkesat e Raportimin ........................................................ 42
5.2. Dorëzimi dhe miratimi i raporteve ........................................ 42

6. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA ..... 43
7. GARANCIA ..... 43
8. MIRËMBAJTJA ..... 43
8.1. Kushtet e nivelit të shërbimit të mirëmbatjes (SLA) ..... 43
8.1.1. Disponueshmëria e sistemit ..... 43
8.1.2. Kufizimet e mundshme ndaj disponueshmërisë së shërbimit ..... 44
8.1.3. Mirëmbajtja e sistemit ..... 44
8.1.4. Matja e cilësisë së shërbimit ..... 44
8.1.5. Kërkesat e shërbimit ..... 44
8.1.6. Menaxhimi i vazhdueshmërisë së shërbimit ..... 45
8.1.7. Trajtimi i informacionit konfidencial ..... 45
8.1.8. Njoftimi i problematikave dhe i vlerësimeve periodike ..... 45
8.1.9. Punonjësit përgjegjës ..... 45
PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT ..... 46
9. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT ..... 46
Integrimi me modulin e Finances te platformes ERP ..... 46
10. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT ..... 46
11. KËRKESAT FUNKSIONALE ..... 47
11.1. Perdorimi ..... 47
11.2. Faturat ..... 47
11.3. Pranimi dhe leshimi i faturave ..... 48
11.4. Bllokskema ..... 50
11.5. Njoftime dhe raporte ..... 51
11.6. Ruajtja e faturave dhe arkivimi ..... 52
11.7. Integrimi me modulin e Finances te platformes ERP ..... 52
12. KËRKESAT TEKNIKE ..... 53

# 1. HYRJE

## 1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare - KESH sh.a (më tej referuar si “KESH”), është një shoqëri tregtare aksionere shtetërore dhe është prodhuesi kryesor dhe më i rëndësishëm i energjisë elektrike në Shqipëri, që administron dhe operon hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin (HEC Fierzë, HEC Koman, HEC Vau i Dejës) të cilët kanë rëndësisë së veçantë për ekonominë e vendit.

## 1.2. Historiku

KESH është një shoqëri tregtare aksionere shtetërore dhe ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin tatimor te Republikes se Shqiperise. Nje proces kyc i zhvillimit te aktivitetit ekonomik te KESH eshteleshimi dhe pranimi i faturave tatimore. Me hyrjen ne fuqi te ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, KESH ne rolin e tatimpaguesit qe leshon fature, ne zbatim te nenit 18 te ketij ligji, ka si detyrim te instaloje sistemin e fiskalizimit dhe te perdorenje zgjidhje te certifikuar software-ike qe mundëson nenshkrimin elektronik te cdo fature duke përdorur certifikaten elektronike. Ky detyrim duhet te zbatohet nga data 01.07.2021, sipas afatit kohor te përcaktuar nga ligji.

## 1.3. Situata Aktuale

KESH ushtron aktivitetin e saj ne katër vendodhje kryesore: KESH Qender ku ndodhen zyrat e administrates qendrore dhe tre njesi prodhimi (HEC Fierzë, HEC Koman, HEC Vau i Dejës). Aktualisht, KESH përdor vetëm nje NUIS/NIPT per regjistrimin dhe kryerjen e procedurave ne zbatim te legjislacionit tatimor dhe nuk përdor NUIS/NIPT sekondare. Pjese e aseteve te korporatës eshte dhe TERMOCENTRALI VLORE Sh.a (TEC Vlora). Kjo shoqëri përdor vetëm nje NUIS/NIPT, te ndryshëm nga KESH, per regjistrimin dhe kryerjen e procedurave ne zbatim te legjislacionit tatimor.

Struktura organizative e shoqërisë eshte e ndare ne departamente, njesi prodhimi dhe drejtori. Struktura përgjegjëse per deklarimin/kryerjen e pagesave dhe deklarimin/dergimin e faturave te shitjes eshte Drejtoria Ekonomike.

Per shkak te mënyrës se organizimit, detyrimeve ligjore dhe procedurave te brendshme, cikli i trajtimit i nje fature tatimore qofte kjo fature blerjeje apo shitjeje përfshin, ne faza te ndryshme, disa struktura organizative/drejtori, te cilat janë pjese e strukturës organizative te KESH. Faturat e blerjes, ne kuptim te gjere, mbështetur ne procedurat e brendshme te trajtimit, kategorizohen si me poshtë:

- Fatura te kontratave të investimeve dhe shërbimeve - te trajtuara nga ndjekësit e kontratave dhe Drejtoria e Prokurimeve (DP);

- Fatura te kontratave të blerjes së energjisë - te trajtuara nga Drejtoria e Operacioneve Tregtare (DOT);
- Fatura të blerjeve të vogla nga KESH Qender - te trajtuara nga Drejtoria e Sherbimeve te Pergjithshme (DSHP);
- Fatura të blerjeve të vogla nga njesite e prodhimit - te trajtuara nga Sektori Ekonomik (SE) ne njësinë përkatëse.

Faturat e shitjes gjenerohen kryesisht nga procesi i shitjes se energjisë se prodhuar dhe hartohen nga DOT, DGJ, njesite e prodhimit dhe DEK dhe trajtohen ngaDEK.Ne funksion te trajtimit te faturave ne përputhje me procedurat e brendshme, te gjitha faturat qe dërgohen për pagese ne drejtim te KESH konsiderohen si *fatura hyrëse* dhe te gjitha faturat qe lëshohen për pagese nga KESH ne drejtim te operatoreve te tjerë ekonomike konsiderohen *fatura dalëse.*Te gjitha faturat firmosen nga punonjësi i ngarkuar me ndjekjen e procesit qe ka prodhuar faturën.

Me poshtë paraqitet ne forme bllok-skeme cikli i trajtimit te faturave hyrëse dhe dalëse:



"Shërbim dhe mirëmbajtje e sistemit të Fiskalizimit", si një zgjidhje software-ike për lëshimin e faturës dhe pranimin e faturës elektronike dhe fiskalizimin e lëshimit të faturës.

*Workflow aktual i faturave hyrese*




*Workflow aktual i faturave dalese*

Sic mund te vihet re dhe nga bllok-skemat, te gjitha faturat firmosen nga punonjësi i ngarkuar me ndjekjen e procesit qe ka prodhuar faturën. Referuar ligjit, firmosja me shkrim nuk do te jete mënje element identifikues dhe autentikues i fatures tatimore dhe si rrjedhoje, per KESH, ne zbatim te procedurave te brendshme, lind nevoja per zbatimin e nje tjetër zgjidhjeje per ngarkimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë per trajtimin e faturave.

## 2. OBJEKTIVAT, RISQET, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

### 2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit të kësaj kontrate do të jetë përmbushja e te gjitha detyrimeve qe rrjedhin nga ligji nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar dhe aktet nen-ligjore te nxjerra per zbatimin e ketij ligji (më tej referuar si "ligji") .

KESH kërkon të zbatoje, të sigurojë sherbimin dhe mirëmbajtjen dhe të garantojë vazhdueshmërinë e sistemit te fiskalizimit. Ky objektiv përfshin dhe zbatimin, sigurimin e shërbimit dhe mirembajtjes dhe garantimin e vazhdueshmërisë se sistemit te fiskalizimit per TEC Vlora, si operator ekonomik me NIPT/NUIS te ndryshëm nga KESH Sh.a.

### 2.2. Qëllimi

Qëllimet e kësaj kontrate janë si më poshtë:

- Sigurimi i shërbimit te sistemit te fiskalizimit si zgjidhje sofware-ike ne formën e nje aplikacioni Cloudperleshimin dhe pranimin e fatures elektronike dhe përshtatja sipas/ose përmbushja e kërkesave funksionale te KESH;
- Fiskalizimi i leshimit te fatures nga platforma ERP qe do te zbatohet nga KESH;
- Mirëmbajtja periodike e sistemit te fiskalizimit dhe mbështetja ndaj përdorueseve të sistemit.

### 2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori

Rezultatet që priten të arrihen gjatë zbatimi të kësaj kontrate janë si më poshtë:

- Permbushja e te gjitha detyrimeve ne zbatim te ligjit, brenda afatit kohor;
- Permbushja e te gjitha kërkesave funksionale te paraqitura nga KESH ne kete dokument, brenda afatit kohor;
- Integrimi me modulin e Finances te platformes ERP (mbas zbatimit te platformes ERP);
- Trajnimi i punonjësve te ngarkuar me përdorimin e sistemit, në KESH dhe TEC Vlora;
- Mirembajtja e sistemit te fiskalizimit dhe garantimi i disponueshmerise te këtij sistemi brenda kushteve te kërkuara për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

### 2.4. Supozimet e projektit

Supozimet kryesore mbi të cilat është bazuar shtrirja e shërbimit janë:

- Zbatimi i te gjitha detyrimeve qe rrjedhin nga ligji nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar dhe akte te tjera ligjore dhe nen-ligjore per realizimin e procesit te fiskalizimit;
- Kontraktimi i një operatori ekonomik te certifikuar nga AKSHI dhe administrata tatimore qendrore si prodhues dhe mirëmbajtës i zgjidhjeve software-ike dhe me eksperiencën e nevojshme në ndërtimin ose integrimin e sistemeve financiare dhe të kontabilizimit;
- Angazhim dhe mbështetje e plotë nga personat e përfshirë në zbatimin e kontratës;
- Qasje e plotë dhe e detajuar në sistemet TIK që mbështesin sistemin e fiskalizimit;
- Vërtetësia, konfidencialiteti dhesasia e duhur e te dhenave te shkembyera midis sistemit te fiskalizimit dhe platformes qendrore te faturave.

- Në asnjë rast, ofruesi i shërbimit nuk duhet të keqpërdorë ose të shpërndajë të dhënat konfidenciale të KESH, të cilat mund t'i ketë përftuar për shkak të nevojës së ndërhyrjes në sistemet TIK te KESH, ose të aksesit qe ka në informacionin mbi funksionimin e infrastrukturës TIK të KESH.

### 2.5. Rrisqet

Rreziqet kryesore që duhen marrë në konsideratë përfshijnë:

- Disponueshmëria e sistemit;
- Integriteti i të dhënave;
- Feedback objektiv dhe i saktë nga personeli i KESH i përfshirë në zbatimin e kontratës.
- Alokimi i burimeve njerëzore të nevojshme për implementimin e këtij projekti

### 2.6. Hapsira gjeografike dhe vendodhja

- Zyrat Qendrore te KESH SHA, Tirane;
- Termocentrali Vlore Sh.a., Vlorë;

### 2.7. Siguria e Sistemit

- Sistemi duhet të jetë kompatibël me pjesën më të madhe të shfletuesve të internetit dhe të ofrojë siguri në shfletim, sipas standarteve;
- Sistemi duhet të sigurojë funksionalitet për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve të përdoruesve.
- Sistemi duhet të sigurojë të gjitha konfigurimet e sigurisë dhe kredencialet e autentifikimit të shoqëruara me një llogari të veçantë si edhe kompleksitetin e fjalëkalimeve të përdoruesve.
- Administrimi i çdo përdoruesi duhet të realizohet nëpërmjet sistemit, nga nderfaqja e të cilit do të mundësohet krijimi i përdoruesve të rinj dhe ndryshimi i atyre ekzistues.

## 3. DETYRAT SPECIFIKE

### 3.1. Dizenjimi i sistemit

- Planifikimi i burimeve njerëzore dhe materialeve të nevojshme për realizimin e projektit;
- Analiza e projektit për të përcaktuar procedurat e punës dhe funksionalitetet e nevojshme;
- Krijimi i skemave të qarkullimit të dokumentit në sistem;

- Krijimi i skemës per arkivimin e faturave.

### 3.2. Zhvillimi i sistemit

- Krijimi i roleve dhe konfigurimi i te drejtave;
- Krijimi i kanalit te komunikimeve midis portalit te faturave online dhe Sistemit te Protokollit dhe Arkiveste KESH, perruajtjen e faturave në forme elektronike ne infrastrukturën TIK të KESH;
- Hartimi i një dokumenti përshkrues të sistemit;
- Zbatimi i sistemit;

### 3.3. Planifikimi i testimit të sistemit

- Plani i testimit duhet të përmbajë skenare të detajuar testimi, si edhe të përcaktojë testuesit, aktivitetin e testimit, kriteret e pranimit dhe marrjes në dorëzim.

### 3.4. Instalimi dhe marrja në dorëzim

- Pajisja me certifikaten elektronike nga AKSHI dhe konfigurimi i certifikatës elektronike ne sistem;
- Regjistrimi i perdorueseve;
- Trajnimi i punonjesve qe do te perdorin sistemin;
- Ekzekutimi i skenarëve të testimit të UAT sipas planit te testimit dhe dokumentimi i rezultateve;
- Korrigjimi i problematikave të raportuara;
- Vendosja në punë;
- Marrja ne dorëzim.

### **3.5.** Fiskalizimi i leshimit te fatures nga platforma **ERP**

- Krijimi i kanalit te komunikimeve midis Platformes Qendrore te Faturave dhe modulit te Finances, te plarformes ERP të KESH;
- Testimi;
- Marrja ne dorëzim.

## 4. LOGJISTIKA DHE KOHA

### 4.1. Vendndodhja

Takimet e punës, konfigurimet, zbatimet e ndryshimeve, trajnimet dhe ofrimi i shërbimit te mbështetjes do zhvillohen ne vendndodhjet si vijon: Zyrat Qendrore te KESH SHA, Tirane dhe Termocentrali Vlore Sh.a., Vlorë;

### 4.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit se kontratës.Periudha per zbatimin e zhvillimeve, konfigurimeve dhe testimeve te kërkuara fillon nga data e nënshkrimit të kontratës dhe zhvillohet brenda 4 (katër) javë pune, të aplikueshme këto gjatë ditëve të punës dhe nëse është e nevojshme edhe në ditë pushimi për zhvillimin e një pjese të testimeve, por jo me vone se data 01.06.2021.

Periudha e mirembajtjestë kontratës do të jetë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj kalendarike nisur nga data 01.07.2021, date nga cila nis dhe detyrimi ligjor per KESH. Ju lutem shihni nenet 4 dhe 5 të Kushteve të veçanta për datën aktuale të fillimit dhe periudhës së zbatimit.

Procesi i fiskalizimit te leshimit te fatures nga platforma ERP do te kryhet pasi te jete zbatuar dhe te jete vene ne përdorim platforma ERP ne KESH. Periudha perfiskalizimin i leshimit te fatures nga platforma ERP fillon nga data e njoftuar zyrtarisht nga KESH dhe zhvillohet brenda 4 (katër) javë pune, brenda periudhës se zbatimit te kontrates.

## 5. RAPORTIMI

### 5.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe, në origjinal dhe të paktën nje (1) kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 10 faqesh duhet të prodhohet pas dy javesh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit.Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa KESH të dërgoj komente mbi raportin fillestar.

- **Raporti Final** me të njejtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, perfshire komentete pranuara nga palët në draft raport.Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

### 5.2. Dorëzimi dhe miratimi i raporteve

Raportet e përmendur më sipër duhet t'i dorëzohen Ndjekësit të Kontrates të identifikuar në kontratë. Ndjekësi i Kontrates është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

Raportimi mbi problematikat e njoftuara dhe ecurinë për zgjidhjen e tyre do të kryhet çdo muaj, në datë 10 të muajit pasardhës.

Raporti do të dorëzohet:

- me email; ose
- si dokument, me mundësinë për t'u shkarkuar, në një portal për ndjekjen e problematikave;
- Me shkrim i firmosur nga ndjekësit e projektit per të dyja palët.

## 6. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Ne perfundim te projektit per zbatimin e platformes ERP ne KESH do te kryhet fiskalizimi i procesit te leshimit te faturës ne modulin e Finances, modul ky i platformes ERP.

Ofruesi i shërbimit do te zbatoje nje zgjidhje e cila mundëson leshimin e faturave nepermjet modulit te Finances dhe si rrjedhoje te mundesoje komunikimin e ketij moduli me Platformen Qendrore te Faturave, ne kohe reale.

Karakteristikat teknike te platformes ERP dhe modulit te Finances do te vihen ne dispozicion pas zbatimit te saj ne KESH.

Komunikimi dhe shkembimi i te dhenave do te kryhet ne perputhje te plote me detyrimet qe rrjedhin nga ligji;

Arkivimi ne forme elektronike i faturave do te kryhet ne Sistemin e Protokollit dhe Arkives te KESH duke shfrytesuar protokollin *sftp.*

## 7. GARANCIA

Periudha e garancisë per fiskalizimin e leshimit te fatures nga platforma ERP fillon nga data e firmosjes se certifikates se pranimit per kete proces dhe përfundon pas një (1) viti kalendarik.

## 8. MIRËMBAJTJA

### 8.1. Kushtet e nivelit të shërbimit të mirëmbatjes (SLA)

KESH kërkon plotësimin e kushteve për nivelin e shërbimit të mirembajtjes sipas pikave mëposhtë:

#### 8.1.1. Disponueshmëria e sistemit

Sistemi duhet të jetë i disponueshëm, funksional dhe i aksesueshëm nga përdoruesit, pa pasur defekte 99.9% të kohës gjatë orarit zyrtar të punës ( e Hënë – E Enjte: 08:00 – 17:00, E Premte: 08:00 – 14:00) duke përfshirë të gjithë modulet, komponentët *software* dhe bazat e të dhënave. Përjashtim bëjnë rastet kur disponueshmëria ndërpritet për shkaqe jo për faj të ofruesit të shërbimit.

Hapësirat kohore për mirëmbajtje të planifikuara në sistem nuk ndikojnë në matjen e disponueshmërisë.

#### 8.1.2. Kufizimet e mundshme ndaj disponueshmërisë së shërbimit

Mirëmbajtja e planifikuar e sistemit kryhet jashtë orarit zyrtar të punës ( E Hënë – E Enjte: 08:00 – 17:00, E Premte: 08:00 – 14:00). Ofruesi i shërbimit sigurohet që procesi i mirëmbajtjes të përfundojë para fillimit të orarit zyrtar të punës në ditën pasardhëse të punës.

Mirëmbajtja e paplanifikuar e sistemit kryhet jashtë orarit zyrtar të punës ( E Hënë – E Enjte: 08:00 – 17:00, E Premte: 08:00 – 14:00). Ofruesi i shërbimit përpiqet dhe vë në dispozicion të gjithë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe teknike që procesi i mirëmbajtjes të përfundojë para fillimit të orarit zyrtar të punës në ditën pasardhëse të punës.

Backup-et periodike, përfshirë ato manuale dhe automatike, të sistemit dhe bazave të të dhënave kryhen jashtë orarit zyrtar të punës ( E Hënë – E Enjte: 08:00 – 17:00, E Premte: 08:00 – 14:00). Ofruesi i shërbimit sigurohet që të gjithë sesionet e punës në sistem janë mbyllur dhe procesi i back-up të përfundojë para fillimit të orarit zyrtar të punës në ditën pasardhëse të punës.

#### 8.1.3. Mirëmbajtja e sistemit

Në rastet kur nevojitet kryerja e proceseve të mirëmbajtjes si upgrade / update të SW dhe HW, restart të sistemit operativ ose restart të bazës së të dhënave dhe ky proces rrezikon disponueshmërinë e sistemit, ofruesi i shërbimit:

- njofton me email dhe vetëm pasi merr konfirmim me email nga KESH vazhdon procesin e mirëmbajtjes;
- per komponentet e sistemit te ciletjane te instaluar ne infrastrukturen TIK te KESH kryen procesin e mirëmbajtjes nën mbikëqyrjen fizike ose onlinenga punonjësit TIK të KESH.

#### 8.1.4. Matja e cilësisë së shërbimit

Si kritere matës për cilësinë e shërbimit, KESH do të përdorë:

- Kohën e disponueshmërisë së sistemit (përqindje e ditë pune në vit);
- Performancë e sistemit (shpejtësia e transmetimit të të dhënave, koha e përgjigjes etj.);
- Numrin e rasteve të ndërprerjes së paplanifikuar të qasjes në sistem (përqindje e ditë pune në vit);
- Anketimin e përdoruesëve (me vlerësim kënaqshëm ose jokënaqshëm).

Matja e cilësisë së shërbimit raportohet çdo 6 (gjashte) muaj nga KESH dhe përfshihet në vlerësimin e përgjithshëm të kontratës.

#### 8.1.5. Kërkesat e shërbimit

Problematikat e njoftuara nga KESH ose të konstatuara nga ofruesi i shërbimit duhet të gjejnë zgjidhje brenda 24 (njezet e kater) orëve nga koha e njoftimit. Në rastet kur nevojitet më tepër kohë, afati i parashikuar për zgjidhjen duhet të njoftohet, i shoqëruar me arsyetim. Në rastin kur afati parashikohet më shumë se 48 (dyzet e tete) orë ai miratohet nga ndjekësit e kontratës.

Shërbimi i mbështetjes nga ofruesi i shërbimit do të kryhet me qasje në distancë (remoteaccess) ose me paraqitje në ambientet e KESH. KESH rezervon të drejtën e mbikëqyrjes fizike ose online,

në kohë reale, të të gjithë procesit të dhënies së shërbimit të mbështetjes. Gjithashtu, KESH mundëson për punonjësit përgjegjës të ofruesit të shërbimit vetëm të drejta qasjeje të përkohshme në sistemet TIK që preken shërbimi i mbështetjes.

#### 8.1.6. Menaxhimi i vazhdueshmërisë së shërbimit

Në rastet kur kërkohet rikuperim i plotë i të dhënave të sistemit ofruesi i shërbimit përpiqet dhe vë në dispozicion të gjithë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe teknike që procesi i rikuperimit të përfundojë para fillimit të orarit zyrtar të punës në ditën pasardhëse të punës.Në rastet kur kërkohet rikuperim i plotë i të dhënave të sistemit, KESH vë në dispozicion backupet e datës paraardhëse (duke referuar datën e njoftimit të incidentit):

- Në nivel sistemi operativ për serverët e virtualizuar;
- Në nivel backupi të bazës së të dhënave për serverët fizikë.

Ofruesi i shërbimit harton planin e rikuperimit të të dhënave duke përfshirë dhe detyrat që i ngarkohen punonjësve TIK të KESH. Plani i rikuperimit të të dhënave dorëzohet brenda 2 (dy) javë nga data e nënshkrimit të kontratës.

#### 8.1.7. Trajtimi i informacionit konfidencial

Në asnjë rast, ofruesi i shërbimit nuk duhet të keqpërdorë ose të shpërndajë të dhënat konfidenciale të KESH, të cilat mund t'i ketë përftuar për shkak të nevojës së ndërhyrjes në sistem, ose të aksesit të mundshëm që ka ndaj të dhënave.

#### 8.1.8. Njoftimi i problematikave dhe i vlerësimeve periodike

Njoftimi për shfaqjen dhe zgjidhjen e problematikave do të kryhet:

- me email, në/nga adresa të përcaktuara me marrëveshje për të dyja palët; ose
- në një portal për ndjekjen e problematikave.

Portali për ndjekjen e problematikave (supportticketsystem) do të vihet në dispozicion dhe mirëmbahet nga ofruesi i shërbimit, duke mundësuar qasjen për punonjësit përgjegjës të KESH.

#### 8.1.9. Punonjësit përgjegjës

Punonjësit e ngarkuar me njoftimin e problematikave do të përcaktohen me marrëveshje, sipas pozicioneve të punës.

Për çdo ndryshim të punonjësve të ngarkuar me detyrat e mësipërme, për të dyja palët, njoftimi kryhet me shkresë zyrtare nga ndjekësit e kontratës, brenda 3 (tre) ditë pune nga koha kur është kryer ndryshimi.

## PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

| Nr. | Emërtimi | Sasia | Çmimi |
|---|---|---|---|
| 1. | Sherbimi mujor i sistemit te fiskalizimit dhe mirëmbajtjes per KESH | 36 | |
| 2. | Sherbimi mujor i sistemit te fiskalizimit dhe mirëmbajtjes per TEC Vlora | 36 | |
| 3. | Zhvillimet dhe konfigurimet | 1 | |
| 4. | Regjistrimi i subjektit dhe operatoreve dhe pajisja me certifikate nga AKSHI | 2 | |
| 5. | Integrimi me modulin e Finances te platformes ERP (mbas implementimit te ERP) | 2 | |
| 6. | Trajnimi i punonjesve të KESH dhe TEC Vlora | 2 | |
| **TOTALI ME TVSH (LEKË)** | | | |

## 9. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

| Nr. | Emërtimi i fazës / Periudha kohore | J1 | J2 | J3 | J4 | V1, V2, V3 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Përgatitja për zbatimin e sherbimit te sistemit te fiskalizimit | ■ | | | | |
| **3** | Konfigurimet dhe testimi | | ■ | ■ | | |
| **4** | Trajnimi i perdorueseve dhe administratoreve | | | | ■ | |
| **5** | Marrja në dorëzim | | | | ■ | |
| **6** | Integrimi me modulin e Finances te platformes ERP | | | | | *Mbas zbatimit te ERP* |
| **7** | Periudha e mirembajtjes | | | | | ■ |

## 10.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Te gjitha të drejtat mbi përmirësimin e kodit burim te instaluar brenda infrastrukturës TIK te KESH dhe dokumentacionin teknik do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor. Kjo vlen per secilen nga pikat e meposhtme:

- Aplikacione kompjuterike ose module aplikacioni kompjuterik te zhvilluar nga ofruesi i shërbimit me qellim zbatimin e projektit / kontrates;

- Permiresime, rregullime, pershtatje dhe konfigurime te aplikacioneve kompjuterike te gatshme me licence (“opensource” ose jo) te kryer nga ofruesi i shërbimitme qellim realizimin e kontrates;
- Strukturat dhe konfigurimet e bazave te tedhenave te ngritura ose te kryera me qellim zbatimin e projektit / kontrates.
- Kodi i fiskalizimit i cili sherben per komunikimin me AKSHI/TATIME do te jete i Operatorit Ekonomik.

Cdo zhvillim aplikacionesh kompjuterike ose module aplikacioni kompjuterik, i realizuar nga ofruesi i shërbimit ne infrastrukturen TIK te KESH, me qellim zbatimin e projektit/kontrates, do të dorëzohet i shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar, së bashku me setin e dokumentacionit teknik që përfshin dokumentacionin teknik të moduleve në veçanti dhe dokumentin teknik në tërësi.

## 11.KËRKESAT FUNKSIONALE

### 11.1. Perdorimi

- Nderfaqja grafike e sistemit do te jete e thjeshte për t’u perdorur nga punonjës jashtë fushes se TIK;
- Proceset do të jenë të thjeshta për tu kuptuar jo vetëm prej punonjesve ne rolin e perdoruesit por edhe strukturës menaxhuese (etj);
- Parametrizimet dhe konfigurimet e sistemit do të realizohen nga ndërfaqja e përdoruesit me te drejta administrative të sistemit, dhe jo me ndryshime në kod apo bazen e te dhenave;
- Sistemi do te mundesoje funksionin e kerkimit sipas atributeve (nr fature, data e fatures, tipi (hyrese, dalese), etj.;
- Kërkimi sipas atributeve që përmbajnë vlera të paracaktuara duhet të behet me liste zgjedhjeje;
- Nderfaqja e kerkimit duhet te mundesoje pastrimin e fushes se kërkimit, për të kerkuar sipas atributeve te rinj.

### 11.2. Faturat

- Funksionet e sistemit do te jene te ndertuara dhe te konfiguruara ne zbatim te plote te dispozitave te ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, dhe te gjitha akteve ligjore dhe nen-ligjore qe jane nxjerre dhe do te nxirren ne zbatim te tij;
- Sistemi do te mundesoje raportimin ne kohe reale te gjendjes se faturave te shitjes, ne lidhje direkte nga Platforma Qendrore e Faturave;

- Sistemi do te paraqese informacion per faturat e leshuara, sipas statusit, te raportuara me sukses apo jo;
- Sistemi do te lejoje krijimin e faturave ne mënyrë manuale;
- Sistemi nuk do të lejojë fshirje rekordesh;
- Sistemi do te mundesoje njoftimin ne kohe te reale, nëpërmjet nderfaqes, te cdo fature te re hyrese. Vec njoftimit, perperdoruesit e kycur ne sistem, ai do te mundesoje kontrollin ne kohe reale te faturave hyrese,te raportuara ne platformen qendrore te faturave ne drejtim te KESH nga shitesit;
- Sistemi do te mundesoje verifikimin e statusit te cdo NIPT-i para se te leshohet fatura.

### 11.3. Pranimi dhe lëshimi i faturave

- Hartimi dhe leshimi i faturave dalese dhe pranimi i faturave hyrëse do te realizohet duke ju përshtatur sa te jete e mundur procedurave te brendshme te KESH;
- Sistemi do te mundesoje krijimin e te pakten gjashte roleve te perdorueseve, te ndare ne tre nivele te drejtash. Nuk përfshihet ketu roli i administratorit te sistemit i cili kryen konfigurimet dhe parametrizimin;
- Sistemi do te mundesoje kufizimin e te drejtave per lexim sipas radheve (queues) te faturave;
- Rolet do te konfigurohen sipas tabeles me poshte:

| Faturat Hyrese | Te drejtat | Faturat Dalese | Te drejtat |
|---|---|---|---|
| Aprovues | me te drejta per aprovim / pranim | Aprovues | me te drejta per aprovim / leshim |
| Konfirmues | me te drejta vetëm per lexim dhe konfirmim radhen e faturave hyrese | Konfirmues | me te drejta vetemper lexim dhe konfirmim radhen e faturave dalese |
| Printues | me te drejta vetëm per lexim dhe printim ne radhen e faturave hyrese | Hartues | me te drejta vetemper lexim dhe hartim ne radhen e faturave dalese |

- Rolet e Aprovuesit per faturat dalese dhe hyrese i përkasin punonjesve përgjegjës te DEK. Keta role kryejne pranimin e faturave hyrese dhe leshimin e faturave dalese. Gjithashtu,

keta role kane te drejta leximine te dyja radhet (queues) e faturave, hyrese dhe dalëse dhe te drejta leximi dhe shtimi te te dhënave ne librat e blerjes dhe shitjes. Ne kuptim te procedures ekzistuese per trajtimin e faturave tatimore keta role kryejne deklarimin e faturave ne sistemin e tatimeve. Ne kuptim te ligjit këta role konsiderohen si *operator* dhe punonjesit e ngarkuar me kete rol do te regjistrohen si te tille ne platformën qendrore te faturave;

— Te gjithe rolet e tjera kane vetem te drejta leximi, printimi, konfirmimi dhe krijimi te drafteve;

— Roli i Konfirmuesit ne radhën e faturave hyrëse i përket punonjësit pergjegjes i cili konfirmon rregullsi ne ne forme dhe përmbajtje te fatures hyrëse para procesit te aprovimit / pranimit;

— Roli i Konfirmuesit ne radhën e faturave dalëse i përket punonjësit pergjegjes i cili konfirmon rregullsine e draftit te faturës dalese;

— Roli i Printuesit i përket punonjesve, te cilet printojne faturat hyrese vetem pas kerkeses per printim nga punonjesit e ngarkuar me ndjekjen e faturave;

— Roli i Hartuesit i perket punonjesit te ngarkuar i cili ploteson draftin e fatures dalese;

— Kerkesat per pranim (deklarim) dhe kerkesat per leshim fature do te kryhen jashte sistemit te fiskalizimit;

— Nivelet e te drejtave te perdorueseve do te organizohen si me poshtë:

  - Te drejta per lexim – leximi dhe printimi i faturave;
  - Te drejta per konfirmim – konfirmimi kryhet brenda nderfaqes se sistemit me ndryshim te statusit te faturës dhe regjistrohet si veprim ne historikun e veprimeve ose ndyshimeve (log) bashke me te dhënat e përdoruesit qe ka kryer veprimin;
  - Te drejta per aprovim – pranimi i faturave hyrëse ose lëshimi i faturave dalëse.

## 11.4. Bllokskema




*Faturat Hyrese*




*Faturat Dalese*

## 11.5. Njoftime dhe raporte

- Sistemi do te mundesoje njoftimin automatik te perdoruesve lidhur me ndryshime apo nderhyrje te mundeshme ne sistem;
- Sistemi do te mundesoje gjenerimin e raporteve si me poshtë:
  - Raport i Gjendjes Aktuale - ku përfshihen te gjithë faturat aktive (te pa arkivuara) ne sistem.
    - te listuara sipas numrit te faturës;
    - te renditura sipas datës se regjistrimit ne sistem;
    - ne format .xls, .xslx ose .csv.
  - Raport i Veprimeve - ku përfshihen te gjithë veprimet e kryera ne sistem per te paktën 90 (nentedhjete) ditët e fundit.
    - te listuara sipas përdoruesit;
    - te përshkruara sipas numrit te faturës dhe veprimit mbi ndryshimin e statusit;

- te renditura sipas datës se regjistrimit ne sistem;
- ne format .xls,.xslx ose .csv.

### 11.6. Ruajtja e faturave dhe arkivimi

- Sistemi do te mundesoje exportin masiv të të dhënave në format dokumentesh .xls, .xslx ose .csv.
- Sistemi do të arkivoje të gjithë faturat në nje hapesirë ruajtje ne Sistemin e Protokollit dhe Arkives te KESH;
- Arkivimi do te kryhet ne menyre automatike, pas 60 (dite) kalendarike pas ndryshimit te statusit ne *e pranuar* ose *e lëshuar* te faturës ne sistem;
- Arkivimi do te kryhet ne format .pdf,të shoqëruara me metadatat e regjistruara, duke ruajtur strukturën fillestare te dokumentit dhe te gjithë elementet e autenticitetit dhe sigurisë dhe duke garantuar vlefshmërinë ligjore te dokumentit per cdo proces auditimi;
- Arkivimi do te kryhet ne nje forme qe te mundesoje funksionin e kërkimit te paktën sipas numrit te faturës, datës se lëshimit te faturës dhe subjektit lëshues;
- Funksioni i kërkimit te faturave do te zbatohet ne Sistemin e Protokollit dhe Arkives te KESH ne nje ndërfaqe (tab) te veçante te përshtatur per kërkimin sipas kushteve te mësipërme duke mundësuar dhe rradhitjen totale te faturave, ne forme tabelare, dhe renditjen sipas faturës, datës se lëshimit te faturës ose subjektit lëshues.

### 11.7. Integrimi me modulin e Finances te platformes ERP

- Kyintegrim do te mundesoje kryerjen e proceseve si me poshte:
  - Krijimin e faturave dalese;
  - Leshimin e faturave dalese;
  - Konfirmin e raportimit prane platformes qendrore te faturave;
  - Konfirmin nga bleresit te faturave dalese;
  - Krijimin dhe lëshimin e faturave shoqeruese;
  - Konfirmimin e faturave shoqeruese;
  - Rakordimin e faturave dalese midis modulit te Finances te platformes ERP dhe platformes qendrore te faturave dhe mënjanimin e leshimit te dyfishte e faturave;
  - Pasqyrimin e raportimeve te konfirmuara ne sistemin e fiskalizimit;
  - Sistemi duhet te suportoje nje nderfaqe te hapur komunikimi, e afte te ofroje konvertimet e nevojeshme te modelit UBL 2.1 te Platformes Qendrore te Faturave me ate te modulit te Finances te platformës ERP te KESH. Cdo komunikim duhet te gjeneroje *log*-e, me qellim auditimin e procesit.

## 12.KËRKESAT TEKNIKE

- Sistemi do te jete plotesisht i mbeshtetur ne teknologjite web, i sigurte dhe i perdorshem ne cloud, pa nevoje instalimi lokalisht ne kliente (PC) apo server. Sistemi do te aksesohet nëpërmjet ndërfaqes web nëpërmjet një shfletuesi (browser);
- Nderfaqja e sistemit do te jete responsive duke perfshire te gjithe funksionalitetet, per te mundesuar punen si nga kliente (PC) te kategorive desktop dhe laptop por dhe nga pajisje te levizshme si telefona smart dhe tablete;
- Komunikimi midis shfletuesit dhe serverit do te kryhet nëpërmjet protokollit HTTPS, i kriptuar me protokollin TSL/SSL;
- Sistemi do te jete i mbrojtur nga sulmet e injektimit të skripteve;
- Sistemi duhet te jete i mbrojtur nga sulmet kibernetike;
- Bazat e të dhënave do te jene të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi;
- Hyrja ne sistem do te sigurohet me kredenciale, perdorues dhe fjalekalim;
- Sistemi do të ofrojë mundësinë e regjistrimit të të gjitha aktiviteteve që ndodhin në ndërfaqen e sistemit, në formë historiku te veprimeve dhe ndryshimeve (logs) të ndara në kategori të ndryshme për të gjitha veprimet dhe ndryshimet që do të kryhen në sistem;
- Sistemi do te jete i integruar me modulin e Finances te platformës ERP ne menyre integrale ose nepermjet *web-services* per te shmangur hedhjen e dyfishte te veprimeve;
- Arkivimi i faturave do te kryhet ne menyre automatike në nje hapesirë ruajtje ne Sistemin e Protokollit dhe Arkives te KESH duke shfrytesuar protokollin sftp me kredenciale te cilat do te krijohen gjate fazës se zbatimit te kontratës. Sistemi i Protokollit dhe Arkives eshte i ndërtuar mbi platformën NewgenOmniDocs, me përshtatje. Platforma eshte e ndërtuar mbi teknologjiteweb duke shfrytëzuar ne back-end Java, ne front-end PHP si dhe baze te te dhënave OracleDatabase 11g;
- Sistemi i Protokollit dhe Arkives te KESH eshte i mbuluar me kontrate mirëmbajtje dhe cdo ndërhyrje apo ndryshim ne kete sistem do te kryhet me miratimin paraprak te DATIK dhe mirëmbajtësit.

**Shtojca 12**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR[3]

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
**< Emri >**

[3] Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

**Shtojca 13**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët □ oferta ekonomikisht më e favorshme □

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera _______________________________
*(me numra dhe fjalë)*

2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera ____________________________
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.____________________________

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ___________________________

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 14**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*

1. ________________________________________
*2.* ________________________________________
*3.*________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit: ______________________

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1.__________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ____________________________

*(me numra dhe fjalë)*

2.__________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ___________________________

*(me numra dhe fjalë)*

Etj.____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:
1.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:
___________________________________________________________________________
___________________________________________________________________________
___________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:
1.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera ______________/ Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*
2.________________________________ ____________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

